



**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**SPITALI RAJONAL DURRËS**

NR. Prot \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“BLERJE MATERIALE PËR KIRURGJINË E KATARAKTËS PËR SPITALIN RAJONAL DURRËS”*.

Nr	Emertimi dhe specifikimet Teknike	Njesi	Sasi per <b>12 muaj</b>
1	Tripan blu me te pakten 0,06%-1ml	flakon	90
2	Viskoelastik Koheziv, 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1 ml	Cope	198
3	Thika korneale nr 3 .0 , per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend	Cope	90
4	Thika korneale , per tynel anesor me tehun prerës 15 0	Cope	90
5	Sol BSS 500 ml	Cope	90
6	Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartixh per injektim , me diameter Optik 6-6.5 mm, gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm , I gjithë diapazoni I dioptrive te perfshije nga - 10D deri ne + 40 D	Cope	191
7	Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, per prerje 2.85-3.0 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	95
8	Kompresa sterile operacioni me bire dhe xhep per mbledhjen e likideve	cope	195
9	Doreza pa puder 7.0	Cope	670
10	Doreza pa puder 6.5	Cope	214
11	Vitrektomi Anteriore kompatibel me fako steleris ose ekivalent	cope	5

Numri i referencës së procedurës **REF-75205-07-14-2023**

**Fondi limit/** Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër **ne total: 3,757,100** (Tre milion e shtateqind e pesedhjet e shtate mije e njeqind ) **Leke, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durres** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

**b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;**

**Argumentimi:** Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

**d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

---

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre të jete jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit ose shumës së loteve për të cilat konkurron operatori. Kërkesa konsiderohet e permbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale në të pakten 1 vit të periudhës së kerkuar.

**Argumentimi:** Ky kriter (pika a dhe b), është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar sipas **nenit 43 pika 2/c dhe të nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285 date 19.05.2021** "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë:

#### **Neni 43**

##### ***Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare***

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) **40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës** ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

#### **Neni 55**

##### ***Procedurë e hapur e thjeshtuar***

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. **Vlera e xhiros së kerkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kerkuara më poshtë, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të permbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i vlerës së kerkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

*c) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo me te vogel se 20%** te vleres së fondit limit të kontrates për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

○ *Autoriteti kontraktor si dëshmi për pervojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontrates, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

○ *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me **piken 4 të nenit 77** të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me **piken 4 të nenit 40** të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura

tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Gjithashtu, referuar **nenit 55 pika 4/b e VKM nr 285 date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar i cili citon qe:“*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

- b) *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*”

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me te vogel se 20% të vlerës së fondit limit të kontrates, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autodeklaratën për Konformitetin me normën MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC ose ekuivalentë të materialeve mjekësore bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë Konformiteti) ose Certifikate FDA kur është e aplikueshme sipas direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, të Prodhuesit, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015 mbi ”Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, per trejetim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kriteret e pikes 1 dhe 2 jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. *Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata*

*të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

3. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, kur në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejitimin e tregëtimit të artikujve të tij.(të përkthyer dhe të noterizuar).

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbështetje në nenin 11 dhe në nenin 12 të Ligjit nr. 105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”. Autorizimi nga Prodhuesi është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

4. Deklarate mbi origjinën e mallit (ku të përcaktohen vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, në të cilën është përcaktuar se: *1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohen. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit tjetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktor e parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në këtë kontekst është kërkuar dhe deklarata e origjinës dhe prodhuesit, me anë të së cilës do të behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.*

5. Per te gjithë artikujt e ofruar duhet te paraqesin mostra ditën e hapjes së ofertave ,me datë në datën e dhe orën e hapjes së tenderit . Dorezimi i Kapioneve /mostrave, te behet pranë Sekretarisë Spitali Rajonal Durres te mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:  
*“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm KVO të procedurës së prokurimit “Blerje Materiale Për Kirurgjinë E Kataraktës Për Spitalin Rajonal Durrës” dhe jo para datës në datën dhe orën e hapjes së tenderit*  
*Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe të firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti*  
*Mbi çdo mostër të dorezuar ofertuesi duhet të shënojë nr rendor të artikullit që përfaqëson sipas formularit të cmimit.*  
*Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.*

Nesë mostrat e dorezuara nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas nr rendor të formularit të cmimit nesë ka mungesë mostrash për artikuj të vecantë ose nesë origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi atëher oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

**Artikujt duhet të kenë ½ datë së prodhimit me datën e skadencës.**

**Argumentimi:** Ky kriter është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e percaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë të materialeve mjekësore që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST, për të bërë të mundur vlerësimin e tyre dhe përmbushjen e kërkesave të DST.

**Keto kritere dhe argumentime janë bërë dhe janë vendosur në bazë të materialit të specifikimeve teknike me nr. 823/3 prot., dt. 27.06.2023 të pergatitur nga grupi i punës i ngritur me urdherin e brendshëm me nr. 823/1 prot., dt. 01.06.2023**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Emertimi dhe specifikimet Teknike	Njesi	Sasi per 12 muaj
1	Tripan blu me të paktën 0,06%-1ml	flakon	90
2	Viskoelastik Koheziv, 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1 ml	Cope	198
3	Thika korneale nr 3 .0 , për të realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend	Cope	90
4	Thika korneale , për tynel anesor me tehun prerës 15 0	Cope	90
5	Sol BSS 500 ml	Cope	90

6	Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartixh per injektim , me diameter Optik 6-6.5 mm, gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm , I gjithë diapazoni I dioptrive te perfshije nga - 10D deri ne + 40 D	Cope	191
7	Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, per prerje 2.85-3.0 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	95
8	Kompresa sterile operacioni me bire dhe xhep per mbledhjen e likideve	cope	195
9	Doreza pa puder 7.0	Cope	670
10	Doreza pa puder 6.5	Cope	214
11	Vitrektomi Anteriore kompatibel me fako steleris ose ekivalent	cope	5

### Percaktimi i Specifikimeve Teknike

1. Flakon 1 ml tryptan blu me perqendrim 0.06%
2. Sodium Hyaluronate me perqendrim te larte nga 1.2%-1.6% me sasi nga 0.8-1.0(ne shiringe ) me
  - a. viskozitet 120.000mPa.
3. Bisturi korneale 3 .0 mm , per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar per kirurgjine e kataraktes (nje perdorimshe)
4. Bisturi korneale 15 grade mm , per te realizuar tynelin anesor kirurgjine e kataraktes (nje perdorimshe)
5. Sol i balancuar elektrolit per kirurgjine e kataraktes 500ml flakon.
6. Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartixh per injektim , me diameter Optik 6-6.5 mm, gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm , I gjithë diapazoni I dioptrive te perfshije nga - 10D deri ne + 40 D
7. Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, Te pershtatet me aparatit fako stellaris dhe te mundesoje kirurgjine e kataraktes per prerje 2.85-3.0 mm me komponentet:setin I/A,mbulesen e ekranit, sleven shtrenguse maje dhe papuci I testimit.
8. Materiali i komprese te jete nonwoven jo plasmas (celofon). Permasat duhet te variojne nga gjatesia 110-130cm gjeresia 80-100cmm te jene te pajisura me xhep per mbledhjen e solucionit ,sterile dhe nje perdorimeshe.
9. Doreza te perbera nga latex 100 natyral dhe pa permbajtje pudre.Te jene sterile per perdorim kirurgjikal.
10. Doreza te perbera nga latex 100 natyral dhe pa permbajtje pudre.Te jene sterile per perdorim kirurgjikal.
11. Vitrektomi Anteriore kompatibel me fako steleris ose ekivalent.

### Afati I levrimit te mallit

Malli duhet te levrohet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi per specifikimet teknike** jane vendosur ne perputhje me nenin 4, pika 38 te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **si dhe ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 823/3 prot., dt. 27.06.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 823/1 prot., dt. 01.06.2023.**



## SHTOJCA 6

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës së mëposhtme.

Afatet e lëvrimet: Levrimi i medikamenteve të bëhet sipas kërkesave të AK.

Nr	Emertimi dhe specifikimet Teknike	Njesi	Sasi per 12 muaj
1	Tripan blu me te pakten 0,06%-1ml	flakon	90
2	Viskoelastik Koheziv, 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1 ml	Cope	198
3	Thika korneale nr 3 .0 , per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend	Cope	90
4	Thika korneale , per tynel anesor me tehun prerës 15 0	Cope	90
5	Sol BSS 500 ml	Cope	90
6	Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartixh per injektim , me diameter Optik 6-6.5 mm, gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm , I gjithë diapazoni I dioptrive te perfshije nga - 10D deri ne + 40 D	Cope	191
7	Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, per prerje 2.85-3.0 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	Cope	95
8	Kompresa sterile operacioni me bire dhe xhep per mbledhjen e likideve	cope	195
9	Doreza pa puder 7.0	Cope	670
10	Doreza pa puder 6.5	Cope	214
11	Vitrektomi Anteriore kompatibel me fako steleris ose ekivalent	cope	5

Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike me nr. 823/3 prot., dt. 27.06.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 823/1 prot., dt. 01.06.2023, si dhe ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimet të mallrave.

#### U ngarkua ne sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit:

Edison Rapi

Pergjegjes i Sektorit te Prokurimit Publik

Muhamed Troplini

Specialist Fushe/Shef Sherbimi Okulistikes

Enis Karaj

Specialist i larte i Sektorit te prokurimit publik